



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel/Fax 04 2226814; 22268142

Nr. 544 Prot.

Tiranë, më 17.05.2017

**V E N D I M**

**Nr. 122, datë 17/05/2017**

***“Për përfundimin e procesit të verifikimit në lidhje me zbatimin e Vendimit Nr. 125, datë 24.11.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1,14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; neneve 77-97, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, si dhe nenit 34 të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit të ardhur nga Bashkia Vlorë me shkresat nr. 9729/1 prot., datë 25.11.2016 dhe nr. 9729/2 prot., datë 30.12.2016, në lidhje me zbatimin e Vendimit Nr. 125, datë 24.11.2015, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit tematik, në lidhje me procesin e deklarimit të statusit të punësimit dhe vlerësimin e rezultateve të punës, në Bashkinë Orikum, aktualisht Njësi Administrative e Bashkisë Vlorë”*, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

**Vërej se:**

Me Vendimin Nr. 53, datë 28.05.2015, *“Për kryerjen e inspektimit tematik në lidhje me procesin e deklarimit të statusit të punësimit dhe vlerësimin e rezultateve të punës për nëpunësit civil në institucionin Bashkia Orikum”*, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka filluar inspektimin, në lidhje me administrimin e shërbimit civil, pranë Bashkisë Orikum. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 125, datë 24.11.2015, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit tematik, në lidhje me procesin e deklarimit të statusit të punësimit dhe vlerësimin e rezultateve të punës, në Bashkinë Orikum, aktualisht Njësi Administrative e Bashkisë Vlorë”* të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në të cilin është vendosur:

1. Të miratojë raportin përfundimtar të inspektimit tematik në lidhje me procesin e deklarimit të statusit të punësimit dhe vlerësimin e rezultateve të punës në Bashkinë Orikum, që do të jetë pjesë e këtij vendimi.
2. Njësia përgjegjëse në zbatim të nenit 115 të Kodit të Procedurave Administrative duhet të kryejë veprimet e mëposhtme administrative, duke nxjerrë aktet përkatëse:
  - a. Të revokohet akti nr. 25 prot., datë 24.03.2014, i deklarimit të statusit të nëpunësit civil në periudhë prove për punonjësen \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “Drejtor Drejtorie” dhe t’i deklarohet statusi i punësimit “nëpunës civil”, i konfirmuar në pozicionin “Shefi i Sektorit të Tatimeve”.
  - b. Të revokohet akti nr. 24 prot., datë 24.03.2014, i deklarimit të statusit të punësimit, për punonjësen \*\*\*\*\* në pozicionin “Shefe në Sektorin e Tatim Taksave në Drejtorinë e Menaxhimit të Financave Publike”, duke i konfirmuar statusin për pozicionin “Inspektore e tatim-taksave”.
  - c. Të bëhet deklarimi i statusit të punësimit si nëpunës civil i konfirmuar, për punonjësin \*\*\*\*\*, në pozicionin që mban aktualisht, “Inspektor i Kontrollit dhe Vlerësimit Tatimor”, duke e ndërprerë periudhën e provës.
  - d. Të ndërpritet periudha e provës dhe të bëhet deklarimi i statusit të punësimit si nëpunës civil i konfirmuar, për punonjësin \*\*\*\*\*, në pozicionin që mban aktualisht, “Kryeinspektor në Drejtorinë e Kontrollit të Territorit”.
3. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative lihet afat **30** ditë nga marrja dijani për këtë vendim. Njësia përgjegjëse duhet të zbatojë vendimin duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në pjesën arsyetuese të tij.

Me kalimin e afatit procedural të lënë për zbatimin e rekomandimeve të vendimit të mësipërm, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me shkresën nr. 662 prot., datë 16.11.2016, “Në lidhje me zbatimin e Vendimit Nr. 125, datë 24.11.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”, i ka kërkuar Bashkisë Vlorë (si trashëgimtari ligjor i njësisë të qeverisjes vendore që janë shkrirë në të, përcaktuar me Vendimin nr. 510, datë 10.06.2015, të Këshillit të Ministrave) informacion në lidhje me masat që janë marrë për zbatimin e këtij vendimi dhe vënien në dispozicion të gjithë praktikës shkrese që materializon zbatimin e ligjshmërisë për këtë rast.

Në përgjigje të kësaj shkrese, Bashkia Vlorë, ka dërguar pranë Komisionerit shkresën nr. 9729/1 prot., datë 25.11.2016, “Kthim përgjigje”. Duke qenë se dokumentacioni i dërguar nuk ishte i plotë, është komunikuar në rrugë telefonike me njësinë përgjegjëse të Bashkisë Vlorë, e cila me shkresën nr. 9729/2 prot., datë 30.12.2016, “Shkresë përcjellëse”, ka dërguar aktet e kërkuara, të cilat materializojnë zbatimin e vendimit.

Pas verifikimit të dokumentacionit shkresor bashkëngjitur shkresave të mësipërme, rezultoi se:

- Njësia përgjegjëse e Bashkisë Vlorë, në zbatim të pikës 2 të vendimit objekt verifikimi ka kryer veprimet e mëposhtme administrative:
  - a. Me aktin nr. 11040 prot., datë 30.12.2016, *“Për statusin e nëpunësit civil”*, ka revokuar aktin nr. 25 prot., datë 24.03.2014, të deklarimit të statusit të nëpunësit civil në periudhë prove për punonjësen \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës *“Drejtor Drejtorie”* dhe i ka deklaruar statusin e punësimit “nëpunës civil”, në pozicionin e punës *“Shefe e Sektorit të Tatimeve”*.
  - b. Me aktin nr. 11041/1 prot., datë 30.12.2016, është revokuar akti nr. 24 prot., datë 24.03.2014, i deklarimit të statusit të punësimit për punonjësen \*\*\*\*\* në pozicionin *“Shefe në sektorin e Tatim Taksave në Drejtorinë e Menaxhimit të Financave Publike”*, duke i konfirmuar statusin në pozicionin e punës *“Inspektore e Tatim-Taksave”*.
  - c. Me aktin e deklarimit nr. 11042 prot., datë 30.12.2016, *“Për statusin e nëpunësit civil”*, nëpunësit \*\*\*\*\* i është bërë deklarimi i statusit të punësimit si nëpunës civil i konfirmuar, në pozicionin e punës që mban aktualisht *“Inspektor i Kontrollit dhe Vlerësimit Tatimor”*.
  - d. Me aktin nr. 11043 prot., datë 30.12.2016, *“Për Statusin e Nëpunësit Civil”*, është ndërprerë periudha e provës për nëpunësin \*\*\*\*\* dhe është bërë deklarimi i statusit të punësimit si nëpunës civil i konfirmuar në pozicionin e punës që mban aktualisht *“Kryeinspektor në Drejtorinë e Kontrollit të Terrenit”*.

Për sa u parashtrua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin Nr. 125, datë 24.11.2015 *“Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit tematik, në lidhje me procesin e deklarimit të statusit të punësimit dhe vlerësimin e rezultateve të punës, në Bashkinë Orikum, aktualisht Njësi Administrative e Bashkisë Vlorë”*, të Komisionerit, rezulton se nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Bashkisë Vlorë janë zbatuar rekomandimet e lëna në vendimin paralajmërues.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, ligjin nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, si dhe në nenin 34 të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

## **V E N D O S A:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit për zbatimin e Vendimit Nr. 125, datë 24.11.2015, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit tematik, në lidhje me procesin e deklarimit të statusit të punësimit dhe vlerësimin e rezultateve të punës, në Bashkinë Orikum, aktualisht Njësi Administrative e Bashkisë Vlorë”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit Nr. 125, datë 24.11.2015.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni, Bashkia Vlorë dhe të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**